

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Raport sondazhi

Tregjet publike në Tiranë



Qershor 2024

Përmbajtja

Rreth sondazhit	3
Opinionet e konsumatorëve	6
Sugjerimet e konsumatorëve	11
Opinionet e tregtarëve	11
Sugjerimet e tregtarëve	13
Aneks I – Pyetësi i sondazhit	14

Rreth sondazhit

Bashkia e Tiranës ka ngritur një numër tregjesh publike që ofrojnë një gamë produktesh ushqimore, fruta – perime, veshmbathje, produkte artizanale etj., për t'i dhënë fund fenomenit të shitjes në rrugë të produkteve ushqimore dhe jo vetëm, duke ofruar standarde dhe siguri më të madhe për konsumatorin.

Gjatë viteve të fundit Bashkia ka kryer investime për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe modernizimin e tregjeve publike. Pazari i Ri është një ndër projektet më të suksesshme, një kontribut midis Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe Bashkisë Tiranë në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare. Sot ky treg dhe zona përreth janë shndërruar në një hapësirë komunitare dhe në një atraksion për vizitorët vendas e të huaj.

Përveç strukturave ekzistuese që kujdesen për tregjet publike, Bashkia e Tiranës ka krijuar Agjencinë e Administrimit të Tregjeve, institucion varësie i dedikuar për administrimin e shërbimeve të tregjeve publike. Kjo agjenci synon manaxhimin më efikas drejt përmirësimit të strukturës së tregjeve, arritjen e standardeve më të larta të tregtimit për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve, krijimin e kushteve më të favorshme për tregtarët, si dhe një sërë kompetencash e detyrash të tjera në funksion të nxitjes së bashkëpunimit me sektorin privat, zhvillimit dhe promovimit e tregjeve publike.

Bashkia e Tiranës gjithashtu ndërmerr vazhdimisht iniciativa për promovimin e tregtisë lokale dhe produkteve vendase, një prej të cilave është nisma “Duaje produktin vendas”. Në kuadër të kësaj nisme është hartuar një plan veprimi për tregjet e fermerëve, të cilat funksionojnë gjatë gjithë vitit si tregje të lëvizshme pa pagesë në zona të caktuara të Tiranës, për të sjellë më pranë konsumatorit produkte vendase të shëndetshme, si dhe për të mbështetur fermerët lokal.

Qëllimi i sondazhit: Ky sondazh ka për qëllim të evidentojë opinionet e konsumatorëve për tregjet publike në Tiranë, vlerësimin për infrastrukturën, cilësinë e produkteve, shërbimin, sfidat dhe nevojat e tregtarëve.

Objektivat:


- a) Shpeshtësia dhe arsyet e blerjeve pranë tregjeve publike;
- b) Produktet që preferojnë të blejnë më së shumti dhe faktorët që ndikojnë në blerje;
- c) Sugjerimet për përmirësim dhe nëse duhet të shtohen tregjet publike;
- d) Sfidat dhe konkurrenca me të cilën përballen tregtarët;
- e) Opinionet për përmirësimin e punës së tregtarëve etj.

Sondazhi u zhvillua gjatë periudhës **maj - qershor 2024** dhe u plotësuan **540** pyetësorë¹ nëpërmjet anketimit **ballë për ballë** pranë tregjeve publike të Bashkisë Tiranë, nga të cilët 500 pyetësorë me konsumatorë rastësorë dhe 40 pyetësorë me tregtarë.


¹Aneks I – Pyetësori i sondazhit

Demografia


Nga *totali i të anketuarve* për këtë sondazh **60** pyetësorë janë plotësuar pranë Tregut të përzierë “Llazi Miho”, 58 pranë Tregut me rroba të përdorura Laprakë, 57 pranë Tregut fruta – perime 4 Dëshmorët, përkatësisht 56 pyetësorë pranë Tregut Pazari i Ri dhe Tregut me rroba të përdorura Selitë etj. (*Grafiku 1*).



Të shpërndarë sipas njësive të banimit, **24%** e të anketuarve janë banorë të Njesisë Administrative Nr. 6, 14% janë banorë të Njesisë Administrative Nr. 2, 13% janë banorë të Njesisë Administrative Nr. 5, 11% janë banorë të Njesisë Administrative Nr. 1 etj. (Grafiku 2).




59% e të anketuarve janë femra ndërsa 41% janë meshkuj. Grup mosha me pjesëmarrjen më të lartë në anketim është 51 – 65 vjeç (46%) etj. (Grafikët 3 dhe 4).




Opinionet e konsumatorëve


Rreth **50%** e konsumatorëve të anketuar janë përgjigjur se *kryejnë shpesh blerje* pranë tregjeve publike, 20% rrallë, 18% shumë shpesh dhe 12% shumë rrallë (Grafiku 5).




Rreth **55%** e të anketuarve janë shprehur se zgjedhin të kryejnë blerje pranë tregjeve publike për shkak të shumëllojshmërisë së produkteve, 31% për cilësinë e produkteve, 27% për shkak të çmimeve konkurruese, 10% nga siguria ushqimore, 4% për të mbështetur shitësit lokal etj. (Grafiku 6).




Produktet që konsumatorët blejnë më së shumti pranë tregjeve publike janë fruta – perime (53%), produkte të tjera ushqimore (30%), veshmbathje, lodra dhe kancelari (28%), produkte bulmeti dhe nënproduktet (22%), produkte mishi ose peshku dhe nënproduktet (11%) dhe produkte artizanale (10%) (Grafiku 7).




Faktorët më të rëndësishëm pse qytetarët zgjedhin tregjet publike rezultojnë çmimet e favorshme (74%), pastërtia dhe siguria ushqimore (64%), cilësia e produkteve (62%), besueshmëria te tregtarët (59%), shumëllojshmëria e produkteve 55% etj. (Grafiku 8).




59% e të anketuarve mendojnë se tregjet publike duhet të shtohen, 30% janë përgjigjur (ndoshta), ndërsa 11% mendojnë që nuk duhet të shtohen (Grafiku 9).



54% e totalit të të anketuarve janë përgjigjur se kanë kryer blerje pranë tregjeve të lëvizshme, ndërsa 46% janë përgjigjur (Jo) (Grafiku 10).



58% e të anketuarve që kanë kryer blerje pranë tregjeve të lëvizshme janë shprehur se *do t'i rekomandonin këto tregje edhe tek qytetarë të tjerë*, 25% nuk do t'i rekomandonin, ndërsa 17% ndoshta do t'i rekomandonin (Grafiku 11).




Sugjerimet e konsumatorëve

Një pjesë e të anketuarve (78) kanë dhënë *sugjerime për përmirësimin e tregjeve publike* ekzistuese (Tabela 1).

<i>Tabela 1. Sugjerimet e konsumatorëve</i>	
	Numër sugjerime
Të përmirësohet pastërtia	36
Të rikonstruktohen tregjet dhe të bëhen më tërheqës për blerësit	17
Të kryhet dezinfektim	14
Të ketë më shumë hapësirë për tregëtim	11
Total sugjerime	78

Opinionet e tregtarëve


40% e tregtarëve të anketuar janë shprehur se *ushtrjnë veprimtarinë* prej 5 – 10 vite, 33% prej 1 – 5 vite, 17% prej më shumë se 10 vite, ndërsa 10% prej 1 viti (Grafiku 12).



Sfidat kryesore me të cilat hasen tregtarët gjatë ushtrimit të aktivitetit (Tabela 2).

Tabela 2. Sfidat kryesore të tregtarëve		Numër komente
Konkurrenca e ambulantëve		15
Mungesë parkimi për automjetet për furnizim		14
Papastërtia		12
Ka dallime në tarifa me komunitetin rom		9
Total komente		50

43% e tregtarëve janë shprehur se *hasin konkurrencë nga subjektet private* për shkak të kushteve të magazinimit që këto subjekte disponojnë, **40%** mendojnë se privatët mund të vendosin çmime favorizuese, **38%** janë shprehur se subjektet private kanë avantazh për shkak të logjistikës më të mirë dhe **37%** nga infrastruktura që ofrojnë tregjet private (Grafiku 13).



Sugjerimet e tregtarëve

Një pjesë e tregtarëve (40) kanë dhënë *sugjerime për përmirësimin e tregjeve publike* ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre (*Tabela 3*).

<i>Tabela 3. Sugjerimet e tregtarëve</i>	Numër sugjerime
Të largohen tregtarët që shesin në rrugë, jashtë tregjeve	12
Tregjet të kenë infrastrukturë më moderne	7
Mos të ketë tarifë për tregtarët	6
Përmirësim të pastërtisë	4
Rikonstruksion të tregjeve	4
Kushtet më të mira dhe mundësi magazinimi	4
Dezinfektimi i tregjeve	3
Total sugjerime	40

Aneks I – Pyetësi i sondazhit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. pyetësi _____

Data e intervistës: _____/_____/2024

PYETËSOR

“TREGJET PUBLIKE NË TIRANË”

Tregu	Nj. Administrative/Lagje	Gjinia		Grup-mosha (vjeç)			
		F	M	18-35	36-50	51-65	Mbi 65

I. Pyetje për konsumatorët

1. **Sa shpesh kryeni blerje pranë tregjeve publike?** (Në Tiranë funksionojnë 10 tregje publike: Blv.P.N. Luarasi, Pazari i Ri, tek shkolla 4 Dëshmorët, Mine Peza, 1 Maji përballë ish-Ekspozitës, Kombinat, Tregu ushqimor Hamdi Pepa, Vasil Shanto, Laprakë, Shkozë)

- Shumë shpesh (çdo ditë)
 Shpesh (çdo javë)
 Rrallë (çdo muaj)
 Shumë rrallë (një ose dy herë në vit)

2. **Pse zgjidhni të blini pranë tregjeve publike?** (Mund të zgjidhni më shumë se 1)

- Çmime konkurruese
 Cilësia e produkteve
 Shumëllojshmëria
 Siguria ushqimore
 Mbështetje për shitësit lokal

Tjetër: _____

3. **Çfarë produktesh blini më së shumti kur shkoni pranë tregjeve publike?**

(Mund të zgjidhni më shumë se 1)

- Fruta/perime
 Produkte bulmeti dhe nënproduktet
 Produkte mishi/peshku dhe nënproduktet
 Produkte artizanale
 Produkte të tjera ushqimore

Tjetër: _____

4. Sa të rëndësishëm janë për ju faktorët e mëposhtëm kur zgjidhni të shpenzoni pranë një tregu publik?

Nr.	Faktorët	Vlerësimi			
		Pak	Disi	E rëndësishme	Pa përgjigje
1	Vendndodhja				
2	Shumëllojshmëria e produkteve				
3	Cilësia e produkteve				
4	Pastërtia dhe siguria ushqimore				
5	Çmimet				
6	Besueshmëria te tregëtarët				
Tjetër					

5. A mendoni se duhet të shtohen tregjet publike në Tiranë?

Po Jo Ndoshta

6. Tregjet e lëvizshme janë pjesë e një plani të hartuar nga BT-ja “*Duaje produktin vendas*”, a keni bërë ndonjëherë blerje pranë këtyre tregjeve?

Po Jo

- Nëse Po, a do t’i rekomandonit këto tregje edhe tek qytetarë të tjerë?

Po Jo Ndoshta

7. Sugjerime për përmirësimin e tregjeve publike ekzistuese:

II. Pyetje për tregtarët:

1. Sa kohë keni që ushtroni veprimtarinë në tregun publik?

- 1 vit
- 1 – 5 vite
- 5 – 10 vite
- Më shumë se 10 vite

2. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat haseni në aktivitetin tuaj të përditshëm?

3. Nëse hasni konkurrencë cilat mendoni se janë arsyet?

- Çmimet favorizuese të tregjeve private
- Infrastruktura që ofrojnë subjektet private
- Magazinat që vendosnin subjektet private në dispozicion
- Logjistika e subjekteve private

Tjetër: _____

4. Çfarë mendoni se do t'a përmirësonte punën tuaj?

Shënim: Ky sondazh organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionet për tregjet publike në Tiranë, vlerësimin për infrastrukturën, shërbimin, cilësinë e produkteve dhe sugjerimet e tregtarëve. Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin Nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjin Nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; Ligjin nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”.